



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 156

Tiranë – E hënë, 7 shtator 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 83/2015, datë 7.9.2015	Për mosheqjen e masës së arrestit në flagrancë dhe për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Armando Prenga..... 11217
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 22, datë 20.8.2015	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar..... 11217
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 23, datë 20.8.2015	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar..... 11217
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 24, datë 20.8.2015	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar..... 11218
Udhëzim i ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 4038, datë 4.9.2015	Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër..... 11218
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 6/4, datë 4.9.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11219
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 14/1, datë 4.9.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar... 11224

**VENDIM**
Nr. 83/2015**PËR MOSHEQJEN E MASËS SË
ARRESTIT NË FLAGRANCË DHE PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR
ARRESTIMIN E DEPUTETIT TË
KUVENDIT TË SHQIPËRISË,
ZOTIT ARMANDO PRENGA**

Në mbështetje të nenit 73, pikat 2, 3 dhe 4, të Kushtetutës, nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pika 5, dhe nenit 119, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Mosheqjen e masës së arrestit në flagrancë për deputetin, zotin Armando Prenga.

II. Dhënie e autorizimit për arrestimin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Armando Prenga, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm me kërkesën nr. 2779/2 prot., datë 6.9.2015.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 7.9.2015

UDHËZIM
Nr. 22, datë 20.8.2015**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618,
DATË 7.9.2006, “TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.030 (dhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.030 (dhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.530 (dhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 13, datë 29.9.2014, i Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2015.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË**
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 23, datë 20.8.2015**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31,
DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.030 (dhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj.



2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10. 530 (dhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 12, datë 20.9.2014, i Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2015.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 24, datë 20.8.2015

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277,
DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I TË VERBRIT”, TË
NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 11.390 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Udhëzimi nr. 14, datë 29.9.2014, i Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2015.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM

Nr. 4038, datë 4.9.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE
UNIVERSALE POSTARE, QË OFROHEN
PA PAGESË, PËR PERSONAT E VERBËR
DHE PJESËRISHT TË VERBËR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 28 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Çdo person i verbër, ose pjesërisht i verbër, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për statusin e të verbërve, si dhe Shoqata e të Verbërve në Shqipëri, përfitojnë marrjen e shërbimeve universale postare pa pagesë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Objektet postare të dërguara në adresë të një personi të verbër, ose pjesërisht të verbër, do të përjashtohen nga të gjitha tarifat e shërbimit universal postar, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror në masën që këto objekte postare të jenë të pranueshme si të tilla në shërbimin e brendshëm të ofruesit të shërbimit universal postar të caktuar.

3. Objektet postare të dërguara nga një person i verbër, ose pjesërisht i verbër, do të përjashtohen nga të gjitha tarifat e shërbimit universal postar, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror, në masën që këto objekte postare të jenë të pranueshme si të tilla në shërbimin e brendshëm të ofruesit të shërbimit universal postar të caktuar.

4. Përjashtimi nga pagesat për dërgesat e objekteve postare do të aplikohet edhe për Shoqatën e të Verbërve në Shqipëri, e cila përfaqëson zyrtarisht personat e verbër dhe pjesërisht të verbër, duke mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

5. Përjashtimi nga tarifat e shërbimit universal postar zbatohet me kusht që dërguesi dhe/ose marrësi të jetë person i verbër sipas pikës 1 të këtij udhëzimi ose kur dërguesi dhe/ose marrësi është një shoqatë e njohur zyrtarisht që vepron në ndihmë të të verbërve sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Objektet postare, në zbatim të këtij udhëzimi, përfshijnë:

a) korrespondencën, literaturën për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në çfarëdo formati (përfshirë regjistrimet me zë);

b) pajisje apo materiale të çfarëdo lloji të përshtatura për të ndihmuar personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në lehtësimin e problemeve të shikimit.

7. Objekte postare, paketa, koliposta të dërguara nga vende të tjera, që përmbajnë materiale për personat e verbër apo për Shoqatën e të Verbërve në Shqipëri, do të përjashtohen nga tarifa e magazinimit dhe dorëzimit.

8. Kufiri maksimal i peshës për objektin postar të dërguar në adrese të, dhe/ose nga një person i verbër dhe pjesërisht i verbër, si dhe në adresë të, dhe/ose nga Shoqata e të Verbërve në Shqipëri për brenda dhe jashtë vendit është deri në 7 kg.

9. Objektet postare për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

a) literatura për të verbrit, të jenë të shtypura në reliev që përdoren nga të verbrit;

b) të ambalazhohen në mënyrë të atillë që të mbrohet mirë përmbajtja, por edhe të mos pengohet një verifikim i lehtë dhe i shpejtë i tyre si objekte për të verbrit;

c) objektet për të verbrit, të pranuar e të adresuara brenda vendit, rekomandohet të pajisen me një etiketë të bardhë me simbolin e paraqitur si më poshtë, me shënimin: “*Objekt postar për të verbër*” dhe në pako postare me mbishkrimin: “*Materiale për përdorim nga të verbrit*”;



d) objektet për të verbrit, të pranuar për jashtë vendit, rekomandohet të pajisen me etiketën me simbolin e mësipërm dhe me shënimin me mbishkrimin në gjuhën frënge: “*Envois pour les aveugles*” dhe/ose në gjuhën angleze me mbishkrimin: “*Items for the blind*”;

e) cekogramet nuk mund të përmbajnë mbishkrime, objekte të korrespondencës, pullë postare, ndonjë formë parapagimi, të anuluar ose jo, ose ndonjë letër që përfaqëson një vlerë monetare, me përjashtim të rasteve kur objekti postar përfshin një kartolinë, zarf ose ambalazh që ka të printuar adresën e dërguesit të objektit ose përfaqësuesit të tij në shtetin e postimit apo të destinacionit të objektit, kthimi i të cilit është parapaguar.

10. Ngarkohet ofruesi i shërbimit universal postar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Milena Harito

UDHËZIM

Nr. 6/4, datë 4.9.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Neni 1

Në pikën 3, të nenit 48, “Eksporte”, kudo në përmbajtje, togfjalëshi “Drejtoria Rajonale Tatimore”, zëvendësohet me “Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”.

Neni 2

Në neni 49, “Procedura e rimbursimit për mallrat në bagazhin personal të udhëtarit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin e parafundit, togfjalëshi “Drejtoria Rajonale Tatimore” zëvendësohet me togfjalëshin “Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”.



Në germën “b”, të pikës 5, togfjalëshi “90 ditë kalendarike” zëvendësohet me togfjalëshin “3 muaj”.

Neni 3

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62

**Rimbursimi i TVSH-së
Rregullat dhe procedura e rimbursimit**

Sikurse përcaktohet në nenin 1 të ligjit nr. 90/2015, datë 23.7.2015, “Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, procedura e rimbursimit të TVSH-së kryhet siç përcaktohet në ligjin për procedurat tatimore dhe udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar”.

Neni 4

Neni 63, “Rimbursimi për marrëveshjet financiare” ndryshon si më poshtë:

“Në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 77 të ligjit, nëse kërkesa për rimbursim është bërë në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar u rimburohet financuesve të huaj nëpërmjet sistemit të thesarit brenda 30 ditëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim. Rimbursimi i kryer për këto raste nuk i nënshtrohet analizës së riskut dhe kontrolli tatimor për rimbursimin e kryer nuk është i detyrueshëm përpara rimbursimit.

Çdo procedurë për rimbursimin apo për financimin e TVSH-së për rastet e mëposhtme, pavarësisht nëse kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo financohen sipas procedurave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996, nga përfituesi vendës, do të përfundojë brenda 30 ditëve, përfshirë edhe rimbursimin e shumave nga strukturat përgjegjëse të Thesarit.

1. Kur pavarësisht përjashtimit, TVSH-ja përballohet (paguhet) direkt nga donatori:

a) Kur projekti realizohet (zbatohet) nga vetë njësia zbatuese

Njësia zbatuese e projektit për qëllime të rimbursimit të TVSH-së duhet të pajiset me NIPT

(certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me ligjin. Njësia zbatuese e projektit regjistrohet në përfundim të afatit të projektit. TVSH-ja mbulohet (përballohet) direkt nga njësia zbatuese e donatorit apo e projektit në Shqipëri si për blerjet brenda vendit, ashtu dhe për importet, njësia paraqet në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

2. Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

3. Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-së që kërkohet të rimburohet.

4. Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin “Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me nr. __, datë __. __. 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje”. Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga drejtoria rajonale e tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

b) Kur projekti realizohet nga sipërmarrës të kontraktuar nga njësia zbatuese

Në këtë rast, në kuadër të zbatimit të projektit, është shoqëria sipërmarrëse e punimeve, e cila për zbatimin e projektit sipas kontratës zbaton TVSH-në mbi vlerën e punimeve, shërbimeve apo furnizimit të mallrave të kryer. Shoqëria sipërmarrëse nga TVSH-ja e faturuar zbret TVSH-në e paguar në blerjet që ka bërë për këtë qëllim, të përballuar nga vetë ajo dhe diferenca përfaqëson



TVSH-në e pagueshme nga kjo shoqëri, TVSH-ja, e cila deklarohet dhe paguhet sipas ligjit. Faturën origjinale të shitjes, së bashku me situacionin e punimeve, shoqëria sipërmarrëse e punimeve ia paraqet njësisë zbatuese të projektit.

Njësia zbatuese e projektit, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me ligjin. Njësia zbatuese e projektit çregjistrohet në përfundim të afatit të projektit. Njësia zbatuese e projektit paraqet në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsytet për rimbursim etj.

2. Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

3. Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-së që kërkohet të rimbursohet.

4. Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin “Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr. __, datë __. __. 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje”. Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga drejtoria rajonale e tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

2. TVSH-ja përballohet nga përfituesi vendës i projektit si kosto lokale

Kryerja e punimeve, furnizimi i mallrave apo i shërbimeve për zbatimin e projekteve do të ngarkohet kurdoherë me TVSH-në, e cila në çdo rast do të paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e

kontraktuar për zbatimin e projektit. Por kjo TVSH do t'i jepet atij përkundrejt paraqitjes së faturës (situacionit) me TVSH-në nga burime të brendshme të financuara nga kosto lokale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996. Kështu, kur donatori nuk merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së, do të veprohet në përputhje me VKM-në nr. 509, datë 12.8.1996. Në bazë të këtij vendimi, TVSH-ja financohet nga përfituesi apo investitori vendës i projektit dhe paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.

3. Në rastin e zbatimit të Marrëveshjeve kuadër “Mbi bashkëpunim dhe zhvillim”, midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, financimet në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë të përjashtuara nga TVSH-ja. TVSH-ja do të financohet nga përfituesi vendës në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe faturohet e paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e furnizimeve për zbatimin e projektit. Skema e zbatimit të TVSH-së do të bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996 “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë”.

Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”” dhe nenit 28 të ligjit nr. 37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), kontraktorët (organizatat jofitimprurëse) e projekteve të financuara nga IPA rimbursohen nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT për TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në



kuadër të të tilla projekteve, pas dorëzimit të kërkesës për rimbursim TVSH-je dhe dokumenteve të tjera të nevojshme sipas këtij udhëzimi.

Me lidhjen e kontratës me delegacionin e KE-së në Tiranë, OJF-të duhet të bëjnë një kërkesë pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar si OJF, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je në kuadër të zbatimit të projektit IPA, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

a) Një kopje të kontratës së noterizuar midis OJF-ve dhe delegacionit të KE-së në Tiranë, në gjuhën shqipe dhe angleze;

b) Emrin e projektit në gjuhën shqipe dhe angleze;

c) Shumën e grantit për projektin përkatës dhe periudha e kohëzgjatjes;

d) Emrin e organizatës jofitimprurëse përgjegjëse për projektin;

e) Dokumentacion që provon statusin jofitimprurës të organizatës.

Drejtorja rajonale tatimore regjistron në një regjister të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të këtyre projekteve dhe lëshon për OJF-të një certifikatë të regjistrimit të projektit për efekt të rimbursimit të TVSH-së sipas formatit nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Një kopje e kësaj certifikate i përcillet delegacionit të KE-së në Tiranë dhe Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në DPT.

Organizata jofitimprurëse i paraqet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar për zbatimin e kësaj kontrate, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatën e regjistrimit për efekt të rimbursimit të TVSH-së;

2. Kopje të faturave origjinale të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të zbatimit të projektit;

3. Vërtetimin e lëshuar nga Komisioni Evropian së bashku me listën e konfirmuar të të gjitha faturave të detajuara për shpenzimet e kryera nga OJF-të në kuadër të projektit të financuar nga IPA.

Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës dhe verifikimit të shumës së pretenduar, Drejtorja e rimbursimit të TVSH-së, në DPT procedon me rimbursimin e TVSH-së.

Në rastet e zbatimit të marrëveshjeve kuadër për bashkëpunim dhe zhvillim, në bazë të të cilave përfitues janë institucionet buxhetore, të cilave, në momentin e importimit, nuk u janë livruar nga Drejtorja e Thesarit fondet buxhetore për pagimin e TVSH-së për importimin e mallrave të përfituara në kuadër të këtyre projekteve, administrata doganore procedon me shtyrje të pagesës së TVSH-së në momentin e importit, për një periudhë deri në tre muaj, me kusht që institucioni buxhetor përfitues të paraqesë:

a) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave: kopje të kontratës së lidhur midis institucionit buxhetor përfitues dhe donatorit;

b) pranë degës doganore që do të akordojë shtyrjen e TVSH-së: urdhrin e pagesës të vulosur nga dega e thesarit përkatës.

Në qoftë se nuk kryhet pagesa brenda periudhës 3-mujore, njoftohet Ministria e Financave".

Neni 5

Neni 64 "Procedura e rimbursimit dhe e përjashtimit për diplomatët, organizatat ndërkombëtare, NATO-n, diplomatët, organizatat ndërkombëtare dhe NATO-n" riformulohet si më poshtë:

"1. Bazuar në nenin 60 të ligjit për qëllime të TVSH-së trajtohen si furnizime të ngjashme me eksportet furnizimet e mëposhtme:

a) furnizimet e mallrave dhe shërbimet e kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore;

b) furnizimet e mallrave dhe shërbimeve ndaj organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarëve të këtyre organizatave, të njohura si të tilla nga ana e autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë ose nga anëtarët e këtyre organizatave, brenda limiteve dhe sipas kushteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë themeluar;

c) Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, të destinuara për forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s, për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato, si dhe për të furnizuar mensat përkatëse për qëllimin e përbashkët të mbrojtjes.

2. Gjithashtu, bazuar në pikën 33 dhe 34, të nenit 56 të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, përkatësisht:



a) Importimet e mallrave të kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore, të cilat përfitojnë përjashtim nga taksat doganore, mbi bazën e reciprocitetit, si dhe importimet e mallrave të kryera nga organizatat ndërkombëtare, të njohura si të tilla prej autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga anëtarët e këtyre organizatave, brenda limiteve dhe sipas kushteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, në bazë të cilave janë themeluar.

b) Importimet e mallrave nga forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s, për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato, si dhe për të furnizuar mensat përkatëse për qëllimin e përbashkët të mbrojtjes.

Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së 0 për qind për furnizimet e mësipërme të kryera brenda vendit, të cilat trajtohen si të ngjashme me eksportet, përcaktohet procedura e mëposhtme e rimbursimit të TVSH-së.

Misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe NATO-ja regjistrohen për TVSH-në dhe të pajisen me Certifikatën e Numrit të Identifikimit pranë autoritetit tatimor.

Për blerjet brenda vendit, misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre, paguajnë TVSH-në në momentin e blerjes, TVSH-në për të cilën do të rimbursohen, me kusht që çdo faturë blerjeje të jetë më e madhe se 10.000 lekë. E drejta e rimbursimit për ambasadat do të jepet në bazë të parimit të reciprocitetit. Me procedurat e rimbursimit të TVSH-së së paguar merret Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila është përgjegjëse edhe për zbatimin e parimit të reciprocitetit. Kjo drejtori do t'i pajisë misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, e personelin e tyre me formularin "Kërkesë për rimbursim", sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Çdo mision diplomatik, organizatë ndërkombëtare për blerjet e bëra nga vetë ato ose nga personeli i tyre, do të dërgojë në drejtorinë e mësipërme dy kopje të formularit "Kërkesë për rimbursim" (të firmosur e të vulosur nga titullari i ambasadës apo i organizatës ndërkombëtare), si edhe faturat origjinale të blerjes. Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Jashtme, kopjen origjinale të formularit "Kërkesë për rimbursim" dhe faturat origjinale të blerjes, i dërgon pranë autoritetit tatimor kompetent të ngarkuar për të kryer rimbursimin, i cili është i detyruar që brenda

30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të mësipërm nga ana e Drejtorisë së Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të bëjë rimbursimin e TVSH-së së paguar sipas faturave përkatëse. Brenda këtij afati, autoriteti tatimor verifikon faturën e lëshuar nga shitësi për misionin diplomatik apo për organizatën ndërkombëtare, regjistrimin e saj në librin e shitjeve, pasqyrimin e të dhënave në deklaratën e TVSH-së për muajin përkatës dhe pagesën e TVSH-së në llogari të autoritetit tatimor.

Pas miratimit të kërkesës për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT i dërgon zyrtarisht Ministrisë së Punëve të Jashtme formularin nr. 3, "Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së", një kopje e të cilit dërgohet zyrtarisht dhe në thesar. Ministria e Punëve të Jashtme përpilon urdhërpagesën për rimbursim (në katër kopje), për çdo trup diplomatik, në bazë të formularit nr. 4 dhe e dërgon pranë degës së thesarit, ku kjo e fundit bën pagesat sipas legjislacionit në fuqi. Dega e thesarit, pasi kontrollon përputhshmërinë e listës përmbledhëse, bashkëlidhur urdhërpagesave me atë të formularit nr. 4, kryen pagesat me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë. Në fund të çdo muaji, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT dhe dega e thesarit bëjnë rakordimet për pagesat e kryera gjatë periudhës mujore.

2. Për sa u përket blerjeve që personeli i NATO-s dhe bazat e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëjnë brenda vendit, ato nuk do të paguajnë TVSH në pikën e blerjes. Për këtë, në pikën e blerjes, përfaqësuesi i NATO-s është i detyruar t'i dorëzojë shitësit një certifikatë livrimi, sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi, mbi bazën e së cilës shitësi harton faturën tatimore me TVSH 0%. Në fund të faturës, shitësi bën shënimin: "Ky përjashtim nga TVSH bazohet në certifikatën e livrimit nr....., datë....." Zyra e autorizuar për lëshimin e certifikatës së livrimit, pranë Komandës së NATO-s, në Republikën e Shqipërisë, brenda datës 10 të çdo muaji, dërgon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, një listë përmbledhëse së bashku me kopjet e certifikatave të livrimit të lëshuara për blerjet e realizuara në muajin paraardhës, që do të shërbejë për kryqëzimin dhe verifikimin e faturave tatimore të lëshuara me TVSH 0% prej personave të tatueshëm që kanë kryer furnizimet."



Neni 6

1. Kërkesa për rimbursim të TVSH-së, të paraqitura para datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të trajtohen nga drejtoritë rajonale tatimore.

2. Kërkesat për rimbursim të TVSH-së, të paraqitura në bazë të këtij udhëzimi, do të trajtohen nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, deri në krijimin e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

UDHËZIM

Nr. 14/1, datë 4.9.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nga ministri i Financave

UDHËZON:

1. Kudo në përmbajtjen e pikës 7, hiqen fjalët “në burim”.

2. Pika 21 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“21.1 Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet deri në 2 për qind të të ardhurave tatimore të mbledhura, për t’u përdorur për investime për përmirësimin dhe për modernizimin e infrastrukturës së mbledhjes së të ardhurave dhe për shpërblime stimuluese, të personelit të administratës tatimore.

21.2 Personelit të administratës tatimore i jepen shpërblime stimuluese, për:

a) efektivitetin e shërbimit të kryer në organet tatimore;

b) kryerjen e një shërbimi me rrezikshmëri të veçantë.”.

3. Pas pikës 28.2 shtohet pika 28.3 me përmbajtjen si më poshtë:

“Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet strukturave të saj që ndjekin çështjet tatimore pranë organeve gjyqësore, publikojnë në linkun e krijuar posaçërisht, për këtë qëllim, në faqen zyrtare të internetit, vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Publikimi i këtyre vendimeve bëhet duke respektuar rregullat për publikimin e informacionit, në mënyrë që tatimpaguesit të jenë të informuar mbi praktikën gjyqësore lidhur me çështjet tatimore. Çdo tatimpagues nëpërmjet këtij publikimi do të sigurohet që të ketë akses për të marrë informacionin që kërkon mbi vendimet e gjykatave për çështje tatimore, gjithmonë në respektim të rregullave të publikimit të informacionit.”.

4. Në pikën 46.1.2 shprehja “20 mijë lekë” zëvendësohet me shprehjen “40 000 lekë”.

5. Në pikën 47 të udhëzimit fjalët “për taksën vendore të biznesit të vogël” zëvendësohen me fjalët “Për sistemin e taksave vendore”.

6. Pika 55 ndryshon në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“55. Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale dhe për vendosjen e sistemeve të monitorimit të qarkullimit.

55.1 Tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave ose shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të përdorin sistemin fiskal nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin në mënyrë të detyrueshme të kuponit tatimor.

Këta tatimpagues janë të detyruar të pajisen, të përdorin dhe të mirëmbajnë pajisjet fiskale në përputhje me dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 781, datë 14.11.2007, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

55.2 Tatimpagues në sektorë të veçantë të ekonomisë, siç përcaktohet në VKM-në janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sisteme të monitorimit të qarkullimit.”.



7. Pika 68.5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“68.5 Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, sipas deklaratës tatimore, me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero dhe për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.”.

8. Në pikën 72.1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Germa “d” ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.”.

Pas germës “d” shtohet germa “e”, me këtë përmbajtje:

“e) Të dhëna për çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, çmimet e referencës së qirave, siç përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.”.

9. Titulli dhe në përmbajtje, pika 73 ndryshon si vijon:

“73. E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore.”.

10. Pas pikës 73.3 shtohet pika 73.4, me përmbajtjen:

“73.4 E drejta e tatimpaguesit për të kërkuar rimbursimin e tepricës kreditore të çdolloj tatimi përfshirë tatimin e paguar tepër, parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore përkatëse.”.

11. Pika 75/1 ndryshon në titull dhe përmbajtje, si më poshtë:

“75/1. “Mënyra dhe procedura për rimbursimin e TVSH-së së miratuar dhe për kompensimin e detyrimeve tatimore me TVSH-në, e rimbursueshme”.

75/1.1 Personi i tatueshëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit për TVSH-në, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëpërmjet kërkesës për rimbursim. Gjithashtu, me kërkesën për rimbursim, përcaktohet shuma që do të kalojë për kompensim të detyrimeve tatimore të papaguara, nëse ka të tilla, përveç detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shumën që do t'i rimburohet nëpërmjet thesarit.”.

Pika 75/1.2 ndryshon:

“Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nëpërmjet strukturave përkatëse të administratës tatimore, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim dhe 30 ditëve për tatimpaguesit eksportues, kryejnë procedurën e rimbursimit sipas këtij udhëzimi dhe miraton tepricën e TVSH-së së zbritshme si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, sipas analizës së riskut, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, e cila shqyrton kërkesën për rimbursim, si dhe kryen të gjithë procedurën e rimbursimit, i kërkon Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse të ushtrojë kontroll tatimor përpara miratimit të shumës së rimbursueshme.

1. Rregullat e rimbursimit

Rimbursimi i TVSH-së kryhet nëpërmjet sistemit të thesarit:

a) brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së eksportuesve të kategorizuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”;

b) brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për tatimpaguesit që nuk kategorizohen më sipër.

Afatet e përcaktuara për rimbursimin e TVSH-së, sipas kategorive të personave të tatueshëm fillojnë nga data e kërkesës për rimbursim të TVSH-së, kërkesë e bërë nëpërmjet formularit, “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së”, sipas modelit të miratuar, datë e cila është e njëjtë me datën e pasqyrimit të formularit, “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së”, në sistemin informatik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Rimbursimi i TVSH-së kryhet sipas një procedure të bazuar në analizën e riskut për rimbursim. Kriteret e riskut janë objektive dhe zbatohen me drejtësi për të gjithë tatimpaguesit. Trajtimi i kërkesave mund të ndryshojë në varësi të shkallës së riskut dhe vlerës së TVSH-së të kërkuar për rimbursim.

Administrimi i procesit të rimbursimit të TVSH-së kryhet në përputhje me rregullat me bazë riskun, të vendosura në regulloren e hartuar nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut pranë DPT-së dhe miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve.

Me marrjen e kërkesës për rimbursim, fillimisht verifikohet nëse kërkesa është bërë nga një tatimpagues eksportues ose jo.



Eksportues për qëllime të këtij udhëzimi konsiderohen eksportuesit e kategorizuar sipas VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” për qëllime të rimbursimit të TVSH-së.

Nëse sipas kriterëve të VKM-së tatimpaguesi është eksportues me risk zero, për periudhën për të cilën kërkon rimbursim, atëherë kërkesa nuk i nënshtrohet analizës së riskut për rimbursim dhe rimbursohet automatikisht.

Nëse tatimpaguesi nuk është eksportues me risk zero (eksportues 100%), por i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv ose është eksportues mbi 60% atëherë duhet të rimbursohet brenda 30 ditëve, por duke iu nënshtruar më parë analizës së riskut.

Nëse tatimpaguesi nuk është eksportues, atëherë kërkesa për rimbursim, i nënshtrohet procedurës normale të rimbursimit duke iu nënshtruar analizës së riskut për rimbursim.

Kërkesat për rimbursim, të cilat pas shqyrtimit nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve konsiderohen pa risk, do të procedohen me rimbursim automatik të shumës së kërkuar, duke mos kryer kontroll të personit të tatueshëm përpara se të miratojë rimbursimin e TVSH-së, ndërsa për kërkesat e tjera, të cilat vlerësohen me risk, rimbursimi i shumës së kërkuar do të kryhet nëpërmjet thesarit pas kontrollit nga zyra ose kontrollit në vend.

2. Procedura e rimbursimit

2.1 Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 77 të ligjit “Për TVSH-në”, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

2.2 Për këtë ai plotëson formularin “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së”, sipas modelit të miratuar në këtë udhëzim. Aplikimi bëhet elektronikisht dhe i kalon për trajtim Drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së, në DPT. Kjo kërkesë regjistrohet automatikisht në regjistrin e posaçëm të rimbursimit të TVSH-së sipas nje rendi kronologjik.

2.3 Kjo drejtori kryen dhe përfundon procesin e verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim në lidhje me:

a) Përputhshmërinë e shumës së kërkuar për rimbursim sipas formularit “Kërkesë për rimbursim”, me shumën e TVSH-së së zbritshme

që rezulton në llogarinë e tatimpaguesit.

b) Plotësimin e kërkesave ligjore mbi kërkesën për rimbursim, të cilat konsistojnë në:

i) Për tatimpaguesit e përcaktuar eksportues, sipas VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për këtë qëllim, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse teprica e TVSH-së së zbritshme të kërkuar për rimbursim është më e madhe se 400.000 lekë;

ii) Për tatimpaguesit e tjerë joeksportues, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse rezulton me TVSH-në të zbritshme për secilën nga tri periudhat e njëpasnjëshme, shumë e cila pas këtyre tri periudhave duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqind mijë) lekë.

Në përfundim të këtij procesi, personi përgjegjës mban një akt për evidentimin e plotësimit ose jo të kriterëve të mësipërme.

2.4 Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton se kriteret nuk janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e parregullt dhe nuk pranohet. Në këtë rast, Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i procesit të verifikimit, nis nëpërmjet postës elektronike për personin e tatueshëm një njoftim me shkrim sipas formatit nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, “Njoftimi për mospranim të kërkesës për rimbursim të TVSH-së”, ku i bëhet e ditur se kërkesa e tij nuk është pranuar, duke dhënë njëkohësisht edhe shkaqet e mospranimit. Ky person i tatueshëm, mund të paraqesë një kërkesë të re për rimbursim sipas rregullave të mësipërme, vetëm pasi të ketë rregulluar situatën dhe të ketë eliminuar shkaqet për të cilat nuk iu pranua kërkesa e mëparshme.

Në këtë rast, Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në DPT bën pasqyrimin e refuzimit në sistemin informatik tatimor duke kaluar shumën e kërkuar për rimbursim nga “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së” në “Tepriçë kreditore e TVSH-së”.

2.5 Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton se kriteret janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e pranuar. Në këtë rast, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës tatimpaguesit i dërgohet njoftim, sipas formatit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, “Njoftim për pranimin e kërkesës për



rimbursim të TVSH-së” dhe tatimpaguesi vihet në dijeni se kërkesa e tij do të procedohet më tej nëpërmjet analizës së riskut për rimbursim. Ky njoftim përmban: i) emrin dhe NIPT-in e personit të tatueshëm; ii) cilësimin nëse subjekti është eksportues ose jo; iii) shumën e kërkuar për rimbursim; dhe iv) datën kur është regjistruar, kërkesa në DPT. Ky njoftim nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Gjithashtu, në të njëjtën kohë një kopje e këtij njoftimi i dërgohet edhe degës së thesarit elektronikisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

Në këtë rast, sipas procedurës, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT vijon me vlerësimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së, sipas kritereve të riskut.

Për qëllime të analizës së riskut, kjo Drejtoria, kur e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë personit të tatueshëm kopjet e faturave të blerjeve apo të deklaratave të importit, për të cilat ka lindur e drejta e zbritjes së TVSH-së.

Në përfundim të procesit që lidhet me vlerësimin e faktorëve të riskut, kryhet procedura e mëposhtme.

2.5.1 Nëse kërkesa për rimbursim konsiderohet pa risk atëherë procedohet me miratimin e rimbursimit dhe kryerjen e procedurave të pagesës nëpërmjet sistemit të thesarit. Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së, në DPT, përgatit për tatimpaguesin njoftimin zyrtar sipas formatit nr. 3, “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”, bashkëngjitur këtij udhëzimi, një kopje të së cilës ia dërgon degës së thesarit elektronikisht ose nëpërmjet shërbimit postar dhe vijon me procedurën për rimbursim nëpërmjet thesarit.

2.5.2 Nëse kërkesa për rimbursim rezulton me risk për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e dërgon në drejtorinë rajonale ku është regjistruar tatimpaguesi për kontroll nga zyra ose në vend para se të rimbursohet. Procedura e kontrollit kryhet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2.5.3 Pas përfundimit të kontrollit nga zyra ose në vend, nxjerrjes së rezultateve përfundimtare të tij, ku saktësohet shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar, dhe pas kryerjes së kompensimeve të nevojshme në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën

e Shqipërisë”, raporti përfundimtar i kontrollit ku detajohet shuma e miratuar për rimbursim dhe shuma e kompensimeve të kryera, në rastet kur kryhen kompensime, i përcillet Drejtorisë të Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e cila njofton tatimpaguesin dhe degën e thesarit sipas formatit nr. 3, “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”, duke vijuar me procedurën për rimbursim nëpërmjet thesarit.

2.6 Pas miratimit të shumës së TVSH-së për t'u rimbursuar plotësohet urdhër-pagesa për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit nr. 4 të urdhërpagesës bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe së bashku me njoftimin në përputhje me formatin nr. 3, pasi nënshkruhen nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, i dërgohen me postë rekomande degës përkatëse të thesarit në dy kopje. Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloset nga dega e thesarit, i kthehet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në DPT. Dega përkatëse e thesarit, regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe paguan brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoria e rimbursimit të TVSH-së rakordon me degën e thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të thesarit) njofton zyrtarisht/elektronikisht Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

2.7 Nëse pas rezultateve të kontrollit kërkesa për rimbursim refuzohet tërësisht ose pjesërisht, mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim edhe nëse është i pjesshëm, personi i tatueshëm njoftohet nga drejtoria rajonale tatimore me një akt njoftim vlerësimi tatimor sipas përcaktimit të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Drejtoria rajonale tatimore, në përfundim të kontrollit nëse kërkesa për rimbursim refuzohet tërësisht ose pjesërisht, mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim edhe nëse është i pjesshëm njofton gjithashtu, Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, e cila nga ana e saj njofton degën e thesarit sipas



formatit nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi për refuzimin e rimbursimit.

Në raste të refuzimit ose të mosmiratimit të një kërkesë për rimbursim, plotësisht ose pjesërisht, për arsye që kanë të bëjnë me rezultatet e kontrollit ose me shkelje të tjera ligjore, personi i tatueshëm ndaj çdo refuzimi ose mosmiratimi për rimbursim, ka të drejtë të apelojë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të gjitha procedurat e mësipërme, për kryerjen e të cilave ngarkohet Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT dhe drejtoritë rajonale tatimore, duhet të procedohen brenda afateve të përcaktuara, përkatësisht 30 ditë për eksportuesit e kategorizuar sipas VKM-së, dhe 60 ditë për tatimpaguesit e tjerë, duke filluar nga data e paraqitjes të kërkesës për rimbursim në Drejtorinë Rimbursimit të TVSH-së. Pagesa e shumës së miratuar për rimbursim kryhet brenda 5 ditëve nëpërmjet sistemit të thesarit.

2.8 Siç përcaktohet në nenin 77 të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, administrata tatimore, para se të procedojë me rimbursimin e TVSH-së për një person të tatueshëm, ka të drejtë ta detyrojë atë person të provojë që qëllimi i veprimtarisë ekonomike është realizimi i transaksioneve të tatueshme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së.”.

12. Pika 96.2.1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“Me përfundimin e procesit të shitjes së mallrave të konfiskuara, të ardhurat nga shitja përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes për zhvillimin e ankandit publik dhe më pas zbatohet radha e pagesës, në përputhje me nenin 79 të ligjit.

Kostot administrative përbëhen nga të gjitha kostot e papaguara më parë për marrjen e masave të sigurisë, sekuestrimit të tyre, vlerësimi, transportit, të publikimit etj.”.

13. Në pikën 99 fjalët “për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare” zëvendësohen me fjalët “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

14. Pika 103.3, paragrafi i parë që përfundon me fjalinë “kërkesa për deklarimin si të pambledhshëm të tatimit duhet të përmbajë” ndryshon:

“Për klasifikimin si të pambledhshëm të një pjese ose të të gjithë detyrimit (borxhit) tatimor, njësia përkatëse e borxhit i paraqet një relacion me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të tatimeve, sipas

të cilit evidenton çdo dokumentacion dhe veprim të kryer për mbledhjen e detyrimit tatimor sipas ligjit dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Ky relacion përmban informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar si vijon.”.

15. Pika 104.1 “b” shfuqizohet dhe pika “ç” ndryshohet:

“ç) 3 vjet pasi ka kaluar në regjistrin pasiv, sipas nenit 44 të ligjit dhe procedurave të pikës 44 të këtij udhëzimi.”

16. Në pikën 105.2.3 shtohet fjalja:

“Në përputhje me pikën “c” dhe “ç” të nenit 105.2 të ligjit, strukturat e hetimit tatimor gjithashtu, përveç zbatimit të masave shtrënguese, kanë të drejtë të marrin masa administrative dhe për kundërvajtjet administrative tatimore”.

17. Pika 105.4 ndryshon:

“105.4. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës.”.

18. Në fund të fjalisë në shkronjën “a” të pikës 107.1 shtohen fjalët: “me afat minimalisht 6 muaj, por jo me pak se afati sipas të cilit vendimi ka marrë formë të prerë”.

19. Në pikën 109.3 fjalët “brenda 3 muajve” zëvendësohen me fjalët “brenda 60 ditëve”. Në fjalinë e dytë të pikës 109.3 fjalët “afati tremujor” zëvendësohen me fjalët “afati 60-ditor”.

20. Fjalja e tretë e pikës 109.3 ndryshon:

“Pra, në asnjë rast koha e shqyrtimit të ankimit nga Drejtoria e Apelit Tatimor nuk mund të kalojë 90 ditë duke filluar nga data e marrjes së ankimit.”.

21. Në pikën 109.4 fjalët “brenda 3 muajsh” ndryshojnë “brenda 60 ditësh”.

22. Në pikën 109.8 b) fjalët “brenda 3 muajsh” ndryshojnë “brenda 60 ditësh”.

23. Në fjalinë e dytë në pikën 109.8 b) fjalët “periudha 3-mujore” zëvendësohen me fjalët “afati 60- ditor”.

24. Në pikën 112 bëhen këto ndryshime:

i) Në pikën 112.1.1 fjalët “prej 25 000 lekësh” zëvendësohen me fjalët “përkatësisht prej 10 000 lekë dhe 15 000 lekë sipas kategorive”;

ii) Në pikën 112.1.2 fjalët “25 000 lekë” zëvendësohen me fjalët “10 000 lekë”;

iii) Në pikën 112.1.3 fjalët “25 000 lekë” zëvendësohen me fjalët “10 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 15 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin”.



Në pikën 112.1.4 fjalët “25 000 lekë” zëvendësohen me fjalët “10 000 lekë”.

25. Pika 114.1.1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“114.1.1 Tatimpaguesi, i cili nuk paguan brenda afatit të parashikuar në ligj shumën e detyrimit tatimor, ose të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06 % të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”.

26. Në pikën 114.1.2, shembulli shfuqizohet.

27. Pika 115.1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“115.1 Nëse tatimpaguesi dorëzon një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”.

28. Pika 115.2 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“115.2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar. Shumë e papaguar e detyrimit tatimor konsiderohet edhe deklarimi i pasaktë i tepricës kreditore, e cila llogaritet si diferencë e tepricës kreditore që duhej deklaruar me tepricën kreditore të deklaruar.”.

29. Pika 115.1.2 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“115.1.2. Një deklaratë tatimore, përfshirë deklarimin e tepricës kreditore, quhet e pasaktë kur nuk është e plotësuar me të dhënat reale financiare të subjektit. Deklarata tatimore do të quhet e saktë kur detyrimi tatimor ose teprica kreditore është llogaritur në mënyrë korrekte dhe për të cilën nuk është bërë asnjë gabim aritmetik ose logjik. Nëse pasaktësia është bërë me dashje, gjë që mund të arsyetohet dhe provohet bazuar në dokumentacionin, faktet dhe rrethanat konkrete, konsiderohet evazion.”.

30. Në shembullin në pikën 115.1.3 hiqet “2008” dhe fjala “interes” zëvendësohet me fjalën “kamatvonëse”.

31. Pika 116 “Evazioni fiskal”, ndryshon më “Evazioni tatimor”, si dhe në përmbajtje ndryshon si më poshtë:

“116.1 Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt. Në kuptim të këtij neni, termi “evazion tatimor” përfshin fshehjen apo shmangien me dashje të detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave (p.sh., shitjeve ose të ardhurave të realizuara), falsifikimin e dokumentacionit kontabël dhe tatimor, marrjen e dokumenteve të falsifikuara për të rritur fiktivisht shpenzimet e biznesit ose të TVSH-së së zbritshme duke çuar në përlllogaritjen e pasakte të shumës së tatimit ose taksës. Klasifikimi i një shkeljeje si evazion tatimor duhet të jetë i argumentuar dhe i mbështetur në prova konkrete.

116.2 Në kuptim të pikës 1 të nenit 116 të ligjit, konsiderohet gjithashtu se kryejnë evazion tatimor duke kryer fshehje të të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore, tatimpaguesit, për të cilët konstatohet se kryejnë këto shkelje dhe për të cilët janë aplikuar dënimet administrative, në përputhje me:

a) pikën 1 të nenit 119 të ligjit,

b) pikën 3 të nenit 121 të ligjit,

c) pikën 1, shkronjat “a” e “b”, të nenit 122 të ligjit.”.

32. Në pikën 119.1 shkronja “b” vlera prej “250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë” zëvendësohet me “50 000 (pesëdhjetë mijë lekë)” si dhe në fund të pikës 119.1 shtohet paragrafi me përmbajtjen:

Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve, pas aplikimit të dënimit administrativ, siç përcaktohet në pikën 119.1, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke bërë kallëzimi penal për tatimpaguesin.

33. Kudo në përmbajtje të pikës 122 në përputhje me nenin 122 të ligjit, pas fjalëve “pajisjes fiskale” shtohen fjalët “dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit.



34. Në pikën 122 .1.1 shkronjat “a”, “b”, “g”, “gj”, në përmbajtje bëhen ndryshimet e mëposhtme:

“122.1.1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që plotësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të qarkullimit;

ii) nëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes “i”, më sipër, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë, ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit;

iii) çdo konstatim i mëposhëm i mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit, si shkelje e përsëritur, konsiderohet evazion tatimor siç parashikohet në nenin 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke bërë kallëzim penal për tatimpaguesin;

b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

ii) për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas verifikimit të parë, ku konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, sipas kërkesave të ligjit, i nënshtrohet një dënimi administrativ me gjobë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

iii) për çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas aplikimit të dy

dënimeve administrative, si më sipër, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin;

g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë;

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.”

35. Pas pikës 128, shtohet pika 128/1 si më poshtë:

“128/1 “Dënime të tjera”

Për shkeljet e konstatuara në rastin kur përgjegjës për të aplikuar TVSH-në është personi i tatueshëm blerës nëpërmjet “autongarkesës së TVSH-së”, aplikohen dënimet si më poshtë:

a) Me gjobë në përputhje me nenin 118 të ligjit, kur ky person nuk ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për TVSH-në, por moslëshimi i faturës nuk sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.

b) Me gjobë në përputhje me nenin 124 të ligjit, kur vepron sipas shkronjës “a”, të nenit 128/1, por në këtë rast, moslëshimi i faturës sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.

c) Me gjobë, në përputhje me pikën 1, të nenit 128 të ligjit, kur ky person ka lëshuar faturë tatimore jo në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin për TVSH-në.

ç) Me gjobë në përputhje me nenin 115, të ligjit, kur ky person i tatueshëm ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në dhe nuk e ka deklaruar atë duke sjellë pasoja në TVSH-në e pagueshme.”

36. Kërkesat për rimbursim të TVSH-së të paraqitura para datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të trajtohen nga Drejtoritë Rajonale Tatimore.

37. Kërkesat për rimbursim të TVSH-së të paraqitura në bazë të këtij udhëzimi, do të trajtohen nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, deri në krijimin e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.



Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në
Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani



**KERKESE PER
RIMBURSIM**

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):
 Emri tregtar i Personit te Tatueshem:
 Emri Mbiemri i Personit Fizik
 Adresa:
 Qyteti/Komuna/Rrethi:
 Numri i telefonit:

Kerkoj rimbursimin e kredise per

Tatimin : periudhen :

Kredia duhet te transferohet dhe/ose rimbursohet ne perputhje me kerkesen qe une kam paraqitur ne vijim. Ne te njejten kohe une e di dhe pranoj qe nje pjese e kredise apo e gjithe kredia mund te perdoret per te shlyer detyrimet qe une mund te kem ndaj zyres se tatimeve.

.....
Nenshkrimi i tatimpaguesit Data

Kontrolluar & Autorizuar nga:
(Per perdorim zyrtar)

.....
Emri i inspektorit Kodi Data e autorizimit

	Tatimpaguesi	Zyra e Tatimeve
[19] KREDIA E RIMBURSUESHME :	[19]	
<i>Shperndarja e rimbursimit:</i>		
[30] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter :		
Taksa Periudha tatimore Numri i vleresimit	[30]	
[31] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter :		
Taksa Periudha tatimore Numri i vleresimit	[31]	
[32] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter:		
Taksa Periudha tatimore Numeric i vleresimit (Kodi i takses: 0-TVSH, 1-Tat.Fitimi, 4-TAP, 5-Sig. shoq, 6-Sig. shend)	[32]	
[33] Totali Transferimeve {[30] + [31] + [32]}:	[33]	
[34] Rimbursim :	[34]	
[35] MBETET PA U SHPERNDARE {[19] - [33] - [34]}:	[35]	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RIMBURSIMIT TE TVSH-SE

Nr. _____ Prot
(Formati Nr. 1)

Datë/...../.....

NJOFTIM PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH

Drejtuar: Tatimpaguesit “ _____ ”

Z. _____

Nipt: _____

Adresa: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj te kryer elektronikisht nepermjet formularit «Kerkese per rimbursim» nr. _____, datë _____, me anë të së cilës keni kërkuar rimbursimin e TVSH-se per shumën _____ lekë (shuma ne fjale), për periudhën _____, bazuar në:

- Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 ”Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar neni 77;
- Udhëzimin Nr.6, date 30.01.2015 ”Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar neni;

Ju njoftojmë se për mosplotësim të _____ (arsyet e mospranimit) _____,

kërkesa juaj për rimbursim të TVSH-së nuk është pranuar nga administrata tatimore.

Pasi të keni rregulluar situatën dhe të keni plotësuar kërkesat e përcaktuara në dispozitat e sipërpërmendura, ju mund të paraqisni një kërkesë të re për rimbursim.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHEM

Ky njoftim i dërgohet personit të tatueshëm nepermjet shërbimit postar, brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së.

Ky njoftim, formati nr.1, është miratuar me Udhëzimin Nr., datë, botuar ne FLZ, date2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RIMBURSIMIT TE TVSH-SE

Nr _____ Prot

Datë/...../.....

(Formati Nr.2)

NJOFTIM PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH

Drejtuar: Tatimpaguesi: “ _____ ”

Z. _____

Adresa: _____

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar nenit të Udhëzimit nr. 6. date.30.01.2015, “Për TVSH-në” i ndryshuar, ju informojmë se është pranuar kërkesa për rimbursim të TVSH-se. Kjo kërkesë sipas procedurës do të nenshtrohet analizës së riskut për rimbursim. Ne vijim do të njoftoheni për procedurat e metejshme.

Emri i Personit të Tatueshëm: _____
Numri i Identifikimit Personit Tatueshëm
NIPT/NUIS: _____

Emri Mbiemri (Administratori/Drejtori) _____

Adresa: _____

Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

Nr. Telefonit, E-mail: _____

Kërkesa për rimbursim Nr. Prot _____

Datë: _____

Eksportues: ¹⁾ _____

Marrveshje Financiare: _____

Shuma e kërkuar në numer dhe fjale : _____

Periudha: _____

Dega e Bankes/Nr. Llogarise bankare: _____

D R E J T O R I I P E R G J I T H S H E M

Shënime:

1.Kjo rubrikë plotësohet nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM Nr._____, datë _____ “ Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për kategoritë e eksportuesve përfutës të rimbursimit të tvsh-së”. Psh (eksportues me risk zero/ eksportues të tjerë).

- Ky njoftim i dërgohet tatimpaguesit, brenda 5 diteve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-se.
- Ky njoftim është i vlefshëm vetëm për njoftimin e fillimit të procedurës së rimbursimit dhe jo për ekzekutimin e rimbursimit. Në rast miratimi ky njoftim do të pasohet me formatin Nr. 3 ku përcaktohet shuma për tu rimbursuar.

Ky njoftim, formati nr.2, është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr....., datë2015, botuar në FLZ, date2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RIMBURSIMIT TE TVSH-SE

Nr. _____ Prot
 (Formati Nr. 3)

Datë/...../.....

NJOFTIM PËR MIRATIMIN E RIMBURSIMIT TË TVSH

Drejtuar: DEGËS SË THESARIT _____

Tatimpaguesit: _____

Z. _____

Adresa: _____

Ne zbatim të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar, neni 77 Udhëzimit Nr., datë2015 "Për TVSH-në", i ndryshuar neni, ju njoftojmë për rimbursimin e TVSH-së me te dhenat si më poshtë:

Emri i Personit të Tatueshëm:	
Numri i Identifikimit Personit Tatueshëm	
NIPT/NUIS:	
Emri Mbiemri (Administratori/Drejtori)	
Adresa:	
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Nr. Telefonit, E-mail:	
Kërkesa për rimbursim Nr. Prot	
Datë:	
Eksportues: ¹⁾	
Marreveshje Financiare:	
Dega e Bankes/Nr. Llogarise bankare:	

Shuma e kërkuar për Rimbursim [1]

(Shuma sipas kërkesës së subjektit)

Shuma e miratuar për Rimbursim 2]

(Shuma e miratuar si e rimbursueshme sipas raportit përfundimtar të kontrollit)

Shuma e përdorur/ mbajtur për kompensim të detyrimeve tatimore..... [3]

Shuma e TVSH për tu rimbursuar ([2]- [3]) [4]

(Shuma që do të kalojë nga thesari në llogarinë bankare të subjektit)

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Shenime:

1) Kjo rubrike plotësohet vetëm nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM Nr., datë "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të tvsh-së". P.sh (eksportues me risk zero/ eksportues të tjerë)

- Ky njoftim (Format Nr 3) përgatitet te pakten ne 5 kopje , 2 prej te cilave i dergohen Thesarit; 1 kopje i dergohet subjektit; 1 kopje ne dosjen e tatimpaguesit dhe 1 kopje ne zyren e protokollit.
- Ky njoftim është i vlefshëm për ekzekutimin nga Dega e Thesarit te rimbursimit te TVSH-se se miratuar nga Administrata Tatimore
- Këtë njoftim i bashkangjitet urdherpagesa (UPR) sipas formatit te miratuar sipas këtij udhezimi dhe i dergohet ne 2 kopje Dege se thesarit, e cila procedon me pagesen brenda 5 diteve. Njera kopje nga te cilat pasi kunderfirmohet dhe vulozet nga Dega e Thesarit i kthehet Drejtorise Pergjithshme te tatimeve
- Ky njoftim pa UPR i dergohet personit te tatueshem qe ka bere kerkesen per rimbursim te TVSH-se.
- Te gjitha shumet ne kete njoftim pervec se ne numer duhet te shkruhen dhe me fjale.
- Ky njoftim Format Nr.3, është miratuar me Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr., datë2015, botuar ne FLZ, date2015.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006